



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-150105/23 dt.20.07.2023, të pronarëve Bahri Hoxha, Zenel Beqiri, Gani Dalipi, Vesel Dalipi, Nuriye Dalipi, Fikrije Gjata, Ferat Gjata, Dibran Gjata dhe Agron Gjata nga Prishtina, dhe investitorët nnp “Standard” shpk, me seli në Prishtinë, rr. “Besëlidhja” nr. 66, Prishtinë dhe “Miri” shpk, rr. “Ndue Perllëshi” ndërtesa “4/3”, nr. 1, me seli në Prishtinë për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm, përkatësisht ndërtesa “4/3”, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “A-20”, të tërsisë urbane “A” të Planit Rregullues “Mati 1”, në rr. “Ndue Perllëshi” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit, e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 21.08.2023, lëshon këtë:

ÇERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Bahri Hoxha, Zenel Beqiri, Gani Dalipi, Vesel Dalipi, Nuriye Dalipi, Fikrije Gjata, Ferat Gjata, Dibran Gjata dhe Agron Gjata nga Prishtina, dhe investitorët nnp “Standard”, me seli në Prishtinë, rr. “Besëlidhja” nr. 66, me numër unik identifikues 80100540, dhe me pronar Nebih dhe Vehbi Zariqi nga Prishtina dhe “Miri” shpk, me seli në Prishtinë rr. “Ndue Perllëshi” ndërtesa “4/3”, nr. 1, me numër unik identifikues 810319344, dhe me pronar Nebih dhe Vehbi Zariqi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 351/04-150105/23 dt.20.07.2023, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm përkatësisht ndërtesa “4/3”, me etazhitet 2B+P+9, të ndërtuara sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-1506187/19 dt.25.11.2019, në emër të Bahri Hoxha, Zenel Beqiri, Gani Dalipi, Vesel Dalipi, Nuriye Dalipi, Fikrije Gjata, Ferat Gjata, Dibran Gjata dhe Agron Gjata nga Prishtina, dhe investitorit nnp “Standard” shpk, me seli në Prishtinë, në parcelën kadastrale nr.1648-0 ZK Matiçan, dhe Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit, 05 Nr. 351/02-150618/19 dt. 25.11.2019, në emër të Bahri Hoxha, Zenel Beqiri, Gani Dalipi, Vesel Dalipi, Nuriye Dalipi, Fikrije Gjata, Ferat Gjata, Dibran Gjata dhe Agron Gjata nga Prishtina, dhe investitoreve nnp “Standard”, me seli në Prishtinë, dhe “Miri” shpk, me seli në Prishtinë, në parcelën kadastrale nr. 1648-0 ZK Matiçan, konkretisht në kuadër të bllokut urban “A-20”, të tërsisë urbane “A”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Ndue Perllëshi”, me numrat 128, 128/1, 130, 130/1, 132, 132/1, 134, 134/1 dhe 136, ku kanë dalje hyrjet e kësaj ndërtese dhe e njëjta do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Çertifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njërive të tyre në evidencat e regjistrimit kadastral.

VI. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët: Bahri Hoxha, Zenel Beqiri, Gani Dalipi, Vesel Dalipi, Nurije Dalipi, Fikrije Gjata, Ferat Gjata, Dibran Gjata dhe Agron Gjata nga Prishtina, dhe investitorët nnp "Standard", me seli në Prishtinë, rr. "Besëlidhja" nr. 66, me numër unik identifikues 80100540, dhe me pronar Nebih dhe Vehbi Zariqi nga Prishtina dhe "Miri" shpk, me seli në Prishtinë rr. "Ndue Perlleshi" ndërtesa "4/3", nr. 1, me numër unik identifikues 810319344, dhe me pronar Nebih dhe Vehbi Zariqi nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 351/04-150105/23 dt.20.07.2023, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm "4/3", me etazhitet 2B+P+9, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban "A-20", të tërsisë urbane "A", të Planit Rregullues "Mati 1", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1648-0 ZK Matičan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-1506187/19 dt.25.11.2019, në emër të Bahri Hoxha, Zenel Beqiri, Gani Dalipi, Vesel Dalipi, Nurije Dalipi, Fikrije Gjata, Ferat Gjata, Dibran Gjata dhe Agron Gjata nga Prishtina, dhe investitorit nnp "Standard" shpk, me seli në Prishtinë, në parcelën kadastrale nr.1648-0 ZK Matičan, dhe Vendimit për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit, 05 Nr. 351/02-150618/19 dt. 25.11.2019, në emër të Bahri Hoxha, Zenel Beqiri, Gani Dalipi, Vesel Dalipi, Nurije Dalipi, Fikrije Gjata, Ferat Gjata, Dibran Gjata dhe Agron Gjata nga Prishtina, dhe investitoreve nnp "Standard", me seli në Prishtinë, dhe "Miri" shpk, me seli në Prishtinë, në parcelën kadastrale nr. 1648-0 ZK Matičan, Prishtinë.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektorit i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-177278/21 dt. 28.04.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Inspeksionit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkesit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojcës 5 nga Udhëzimi Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/1.Inspeksioni i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.1.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.a.2.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.c.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/2.d.Inspeksioni i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/3.Inspeksioni i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspeksionit/4.Inspeksioni i instalimeve të ujit; Inspeksioni i sigurisë nga zjarri; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikqyrësi Fisnik Lushaku; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikqyrësi Bekim Mustafa; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikqyrësi Lavdit Sherifi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektike, nga mbikqyrësi Asmir Hamdi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Bashkim Halabaku; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikqyrësi Bashkim Halabaku; Raportin e përfundimit të punëve të mbrojtjes kundër zjarrit, nga mbikqyrësi Nazmi Bajrami; Inçizimin gjeodezik të ndërtesave, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga kompania e licensuar gjeodezike "GEO-GROUP" me nr. të licensës 47;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspeksionit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, si dhe Raportin e Inspeksionit Final konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoret.



Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezentuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumëbanesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shumëbanesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Çertifikate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Çertifikatë, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit, brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Çertifikatë. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 351/04-150105/23 DT. 21.08.2023**

Zyrtarja,
Bahtije Vllasaliu
B. Vllasaliu

Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



